

Të Nderuar Qytetarë,

Për çdo shqetësim Tuajin, për të cilin Ju keni nevojë të merrni një përgjigje, ne Ju ofrojmë një mënyrë komunikimi më të shpejtë e më efikase se letrat e shkruara me dorë, të cilat kalojnë nëpër hapa të cilët mund të vonojnë përgjigjen tonë duke llogaritur këtu dhe kohën që nevojitet për shkëmbimin e pyetje përgjigjive në rrugë postare. Për t`Ju ofruar mundësinë që të merrni një përgjigje në një kohë prej 10 dite pune, Ju ftojmë të rregjistroheni në platformën:

“Shqipëria që duam”

www.shqiperiaqeduam.al

“Shqipëria që duam” është një platformë e hapur komunikimi dhe ndërveprimi, e cila do të shërbejë për t`Ju dëgjuar në kohë reale për çështje të aktualitetit politik e qeverisë; për të diskutuar me Ju reforma e masa të rëndësishme, duke mundësuar ndikimin Tuaj mbi politikën qeverisëse në çdo sektor apo mbi ecurinë e punës së çdo ministrie e institucioni shtetëror. Kjo platformë është një instrument praktik i bashkëqeverisjes me çdo njeri të zakonshëm, që dëshiron të jetë pjesë e përpjekjes për Shqipërinë që duam.

Për rregjistrim mund të ndiqni hapat e mëposhtem:

1. Në Google shkruani: <https://www.shqiperiaqeduam.al/>

E cila do t`ju drejtojë tek:

<https://e-albania.al/mobile/regjistrohu.aspx?ref=shqdapp>

2. Vendosni Kodin e paraqitur dhe vazhdoni më tej.
3. Në faqen pasardhëse vendosni NID (Numri personal) dhe të dhënat tuaja si ju kerkohen.
 - Kodi i përdoruesit (Numri personal NID):
 - Fjalëkalimi (Minimumi 7 karaktere):
 - Fjalëkalimi përsëri:
 - E-mail:
 - Nr. Celular (Formati 06xxxxxxxx):
 - Pyetja e sigurisë:
 - Të dhënat e përdoruesit: ku perfshihen: Emri:, Atësia:, Mbiemri: Datëlindja
4. Pas miratimit të të dhënave tuaja personale shtypni “Rregjistrohu”.

Tashmë, Ju jeni rregjistruar dhe jeni pjesë e platformës “Shqipëria që duam”.

Më pas logohuni në <https://www.shqiperiaqeduam.al/> dhe shprehni mendimin tuaj në çdo rubrikë të Platformës si: Ankesa Ime, Nisma Ime, Fjala Ime, Interpelanca Ime, Nota Ime, Shkolla Ime, Biznesi Im, Kuvendimi Ynë, Dua Të kontribuoj, Historia Ime.

Ne jemi aty për t`Ju dhënë përgjigje brenda kohës së përcaktuar.

Shënim: Në platformë mund të rregjistroheni dhe të logoheni edhe duke përdorur një aplikacion nga telefoni juaj “Android” ose “iPhone” të cilin mund ta shkarkoni në “APP ose PLAY store” duke kërkuar “Për Shqipërinë që Duam”

Ju Mirëpresim,

Zyra e Bashkëqeverisjes
Agjencia për Dialog e Bashkëqeverisje